AMF

KESHILLI MBIKËQYRËS
Rr. Papa Gjon Pali II, Vila Nr. 5 Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355 4 238999 – 238899 Cel: 00355 69 20 70659 Fax: 00355 4 223841 E-mail: info@yeurosig.al

**Shoqëria "EUROSIG" sh.a.**
NIPT:K41926801W

Nr. 5797 Prot.

Datë 26/12/2023

**VENDIM**

**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE**

Nr. 21, Datë 26/12/2023

**PËR**
**ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË**

Sot në Tiranë,më 26/12/2023 ora 12:00,në selinë e shoqërisë "Eurosig"sha, Rruga "Papa Gjon Pali II-të"Vila 5,Tiranë-Shqipëri,Asambleja e Aksionarëve në mbledhjen e saj diskutoi mbi:

- Miratimin e zmadhimit të kapitalit aksionar të Shoqërisë së Sigurimeve "Eurosig"sha,nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja të cilat do të shlyhen me kontribute në mjete monetare,në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9901,datë14.04.2008,*"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*i ndryshuar,ligjit nr.52,datë 22.05.2014 *"Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"*, i ndryshuar.

Janë të pranishëm në mbledhje anëtarët e Asamblesë së Aksionarëve si më poshtë:

1. Z. Kadri Morinaj zotërues i 58.21% të aksioneve
2. Z.Xhevdet Morina zotërues i 15.82% të aksioneve
3. Z.Gazmen Neza administrator i Euro-Alba.Ea shpk,zotërues i 25.69 % të aksioneve
4. Z.Ylli Merkaj zotërues i 0.28% të aksioneve

Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë"Eurosig"sha në mbështetje të neneve 135,168,169 dhe 178 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" i ndryshuar,me 100%të votave,

## V E N D O S I:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë"Eurosig"sha,nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja në vlerën e 1,750,000,000 lekë,të pagueshme me kontribute në mjete monetare,nga aksionari ekzistues,shoqëria "Euro-Alba.EA" shpk me përfaqësues ligjor Z.Gazmen Neza,duke e rritur kapitalin e shoqërisë nga 2,765,650,000 lek në 4,515,650,000 lek

2. Të miratojë ndryshimet që vijnë si rezultat i kësaj rritje kapitali të paguar me mjete monetare,në numrin e aksioneve si dhe vlerat e pjesëmarrjeve aksionare dhe kapitalin themeltar aksionar të shoqërisë Eurosig sha,sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | EMËR, MBIEMËR/ EMËRTIM | ISHTE | | | BËHET | | | VLERA QË SHTOHET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PËRQINDJA | NUMRI AKSIONEVE | VLERA NË LEK | PËRQINDJA | NUMRI AKSIONEVE | VLERA NË LEK | |
| 1 | Kadri MORINAJ | 58.207% | 160,981 | 1,609,812,271 | **35.65%** | 160,981 | 1,609,812,271 | 0 |
| 2 | Shoqëria "EURO-ALBA.EA" shpk | 25.693% | 71,059 | 710,590,000 | **54.49%** | 246,059 | 2,460,590,000 | 1,750,000,000 |
| 3 | Xhevdet MORINAJ | 15.819% | 43,749 | 437,487,729 | **9.69%** | 43,749 | 437,487,729 | 0 |
| 4 | Ylli MERKAJ | 0.281% | 776 | 7,760,000 | **0.17%** | 776 | 7,760,000 | 0 |
| **4** | **T O T A L I** | **100.0%** | **276,565.0** | **2,765,650,000** | **100.0%** | **451,565** | **4,515,650,000** | **1,750,000,000** |

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë “Eurosig sha për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

***Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.***

**AKSIONARËT:**

**KADRI MORINAJ**

**XHEVDET MORINA**

**SHOQËRIA “EURO-ALBA-EA”, SHPK**
**PËRFAQËSUAR NGA Z. GAZMEN NEZA**

**YLLI MERKAJ**